R E P U B L I K A   E   S H Q I P Ë R I S Ë

**BASHKIA KOLONJE**

**KËSHILLI I BASHKISË**

**PROJEKT - VENDIM**

**Nr.        Datë    /     /2025**

**"PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.136 DATË 23.12.2024 "PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE TË BASHKISË KOLONJË DHE NDËRMARRJEVE TË VARËSISË SI DHE NIVELIN E PAGAVE PËR VITIN 2025"**

Projekt – Vendimi që po ju paraqesim bazohet në Ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" Neni 6 pika c), neni 9 pika a) i Ligjit Nr. 35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administrates publike, si dhe të pages bazë minimale në shkallë vendi",Ligji Nr.10405, datë 24.03.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", Ligjit Nr.68/2017, datë 27.04.2018 "Për financat e vetëqeverisjes vendore",Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimi Nr.503, datë 01.08.2024 "Për disa ndryshime në Vendimin Nr.328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore" Vendimi Nr.109 date 26.02.2014 " Për vleresimin e rezultateve ne pune të nëpunësve civile"

**PROPOZOJMË:**

1. Të miratohet niveli i pagave për punonjësit e zgjedhur ose të emëruar në bashkinë Kolonjë, në institucionet dhe ndërrmarjet e varësisë sipas tabelave bashkëlidhur.
2. Ky Projekt – Vendim hyn në fuqi sipas Ligjit Nr. 139/2015 2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".
3. Ky Projekt – Vendim hyn ne fuqi pas 10 ditësh dhe i fillojnë efektet financiare nga data 01 Gusht 2025.

**KRYETARI**

**ERION ISAI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – BASHKIA KOLONJË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA KOLONJË**

Nr.4406 Prot. Ersekë më 22.08.2025

**RELACION**
**PËR**

**PROJEKT-VENDIMIN**
**Nr.____ Datë__________**

**"PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.136 DATË 23.12.2024 "PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE TË BASHKISË KOLONJË DHE NDËRMARRJEVE TË VARËSISË SI DHE NIVELIN E PAGAVE PËR VITIN 2025"**

Projekt – Vendimi që po ju paraqesim bazohet në Ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" Neni 6 pika c), neni 9 pika a) i Ligjit Nr. 35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administrates publike, si dhe të pages bazë minimale në shkallë vendi",Ligji Nr.10405, datë 24.03.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", Ligjit Nr.68/2017, datë 27.04.2018 "Për financat e vetëqeverisjes vendore",Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimi Nr.503, datë 01.08.2024 "Për disa ndryshime në Vendimin Nr.328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", Vendimi Nr.109 date 26.02.2014 " Për vleresimin e rezultateve ne pune të nëpunësve civile"

Të nderuar Këshilltarë,
Duke u mbështetur në analizën vjetore të realizuar mbi funksionimin dhe performancën e çdo drejtorie në Bashkinë Kolonjë si dhe duke marrë në konsiderate vështirësitë e evidentuara gjatë ushtrimit të detyrave dhe përmbushjes së angazhimeve institucionale, Bashkia Kolonjë, në ushtrim të kompetencave të saj, propozon rishikimin e nivelit të pagave për disa nga drejtoritë

përkatëse.
Ky propozim synon harmonizimin e shpërblimit financiar me ngarkesën e punës dhe

përgjegjësitë funksionale të secilës drejtori, në përputhje me parimet e barazisë, proporcionalitetit dhe eficiencës në administratën publike.

Vlerësimi është bërë sipas kriterëve të matjes së performances që u bë për 6 mujorin e pare të vitit 2025 , ku përfshihen:

1. Objektivat dhe matesit e performances.
2. Sjellja professional.e
3. Gabimet dhe saktesia në pune.
4. Realizimi në kohe i punes
5. Kolegjialiteti i marrdhënieve
6. Gatshmëria për punën në grup.

**Niveli I pagës për funksionarët dhe nëpunësit civilë në Bashkinë Kolonjë.**

| Nr. | EMËRTIMI | Kategori | Paga për Pozicion( ishte) | Bëhet | Grupi I Diplomës |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Nënkryetar ( Ristana Gjergo) | - | 185,000 | 175,000 | - |
| 2 | Sekretar I Përgjithshëm | I-5 | 170,000 | 160,000 | 1 |
| 3 | Drejtor I Çeshtjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike | II-2 | 141,000 | 136,000 | 1 |
| 4 | Drejtor I Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural | II-2 | 141,000 | 131,000 | 1 |
| 5 | Drejtor I Planifikimit, Zhvillimit dhe Lejave | II-2 | 141,000 | 126900 | 1 |
| 6 | Drejtor I Arsimit | II-2 | 141,000 | 126900 | 1 |
| 7 | Drejtor I Turizmit dhe Agroturizmit | II-2 | 141,000 | 131,000 | 1 |
| 8 | Drejtor I Mbrojtjes Civile | II-2 | 141,000 | 126900 | 1 |
| 9 | Përgjegjës në Sektorin Juridik | III-2 | 105,000 | 100000 | 1 |
| 10 | Përgjegjës në Sektorin e Prokurimeve Publike | III-2 | 105,000 | 100000 | 1 |
| 11 | Përgjegjes në Bordin e Kullimit | III-2 | 105,000 | 95000 | 1 |
| 12 | Specialist | IV- 3 | 70,000 | 65,000 | 1,2,3 |
| 13 | Inspektor | IV- 3 | 70,000 | 65,000 | 1,2,3 |
| 14 | Administrator | - | 140,000 | 130,000 | - |

Nga sa me siper kërkojme nga ana juaj miratimin e këtij Projekt – Vendimi.

*Konc: Përgjegjëse në Sektorin Juridik: Dorina Tallo*
*Konf: Drejtor i Çeshtjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike : O.Lifo*
*Drejtor i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse: L. Butka*
*Drejtor i Ekonomisë, Financës dhe Buxhetit :G.Duka*
*Miratoi: Sekretari i Përgjithshëm: S. Rexhepi*
*Kopje: 5 (pesë)*

**KRYETAR**

**ERION ISAI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA KOLONJË -